

FJALA E PRESIDENTIT MOISIU NË CEREMONINË E INAGURIMIT TË MUZEUT YAD VASHEM

**I nderuar zoti President,
Zonja e zotërinj,**

Unë kam patur moshën e një nxënësi të shkollës kohën kur bota përjetoi Holokaustin, një nga aktet më të errëta të regjistruara në kujtesën historike të njerëzimit. Si qytetar i një vendi të pushtuar, të varfër dhe të etur për liri, pata fatin të jem dëshmitar i disa prej akteve më humane, qytetare dhe fisnike të popullit tim: duke i rezistuar pushtimit shqiptarët strehuan dhe ndanë ditët e dhimbshme të luftës me disa mijëra hebrenj, një pjesë e të cilëve zgjodhën Shqipërinë për të jetuar. Shqipëria ishte i vetmi vend evropian ku në mbarim të Luftës së Dytë Botërore kishte brenda kufijve të saj, më shumë hebrenj sesa në fillim të luftës. Ne u jemi mirënjohës prindërve tanë që edhe pse në luftë vetë e me privacione të mëdha, nuk pranuan pakte dhe kompensime në dëm të jetës së hebrenjve.

Nga ajo periudhë e errët e historisë së popullit hebre dhe e Evropës kanë kaluar shumë kohë. Të paktën dy breza kanë lindur dhe sot kemi hyrë në shekullin e ri të informatikës dhe globalizmit. Ecja kalendarike e kohës nuk na lejon të harrojmë atë çfarë ndodhi, të meditojmë dhe të reflektojmë mbi të; të nderojmë milionat e pafajshëm dhe të edukojmë sa më mirë brezat e rinj në mënyrë që e kaluara e hidhur të mos përsëritet kurrë më. Yad Vashemi është një portë e hapur që na fton për të kujtuar me respekt e për të reflektuar. Ai është një simbol i gjallë i sakrificës që na inspiron të marrim më shumë përgjegjësi ndaj fëmijëve tanë e brezave që do vijnë, ndaj të ardhmes së njerëzimit në paqe e zhvillim për të gjithë.

Zonja e zotërinj,

Është për të ardhur keq që tmerret e Luftës së Dytë Botërore nuk mjaftuan për të mos lejuar përsëritjen e genocidit në vende e rajone të ndryshme të botës, si në Kamboxhia dhe Ruanda. Unë vij nga një rajon në zemër të Evropës ku Bosnja dhe Kosova u bënë viktimat e radhës së urrejtjes dhe spastrimeve etnike. Sot paqja dhe siguria në botë përballen me një rrezik të ri global: terrorizmin ndërkombëtar. Faktet e mësipërme duhet të na bëjnë më tepër vigjilentë dhe më të vendosur në përpjekjet dhe luftën tonë ndaj të keqes. Pikëpamja jonë është se krahas nevojës për zhvillim, progres dhe forcim të demokracisë, sfida jonë e pashmangshme do të jetë aftësia për të bashkëjetuar me njëri tjetrin, për të ndërtuar një botë në paqe. Jam i bindur se Yad Vashemi me dëshmitë e tij të jashtëzakonshme na ndihmon ta kuptojmë më thellë dhe ta përballojmë më mirë këtë sfidë. Në këtë kontekst, Shqipëria gëzohet për hapat inkurajuese dhe të nevojshme të bëra kohët e fundit në drejtim të zgjidhjes paqësore të krizës në Lindjen e Mesme.

Ju faleminderit!

**THE SPEECH OF PRESIDENT MOISIU AT THE INAUGURATION CEREMONY
OF YAD VASHEM MUSEUM
Jerusalem, March 16, 2005**

**Distinguished Mr. President,
Ladies and Gentlemen,**

When the world lived through the *Shoah*, one of the darkest acts engraved on the historic memory of civilization, I was at the age of a pupil. As citizen of an occupied, impoverished and freedom thirsty country, I was fortunate to witness some of the most humane, civil and noble acts of my people: resisting to the occupation, the Albanians sheltered and shared the war's grieving days with thousands of Jews, a part of whom chose Albania to live. Albania was the only European country where at the end of Second World War counted inside its border more Jews than it had at the beginning of the war. We are grateful to our parents, who even though at war themselves and suffering great deprivations, did not accept pacts and compensations at the disadvantage of the life of Jews.

A long time has passed from that dark period of the history of Jewish nation and of Europe. At least two generations have been born and we are living now at the new century of computing and globalization. The calendared progress of time does not allow us to forget what happened, we should meditate and reflect on it; we should honor the innocent millions and educate as best as possible the younger generations in order that the bitter past will never be repeated. Yad Vashem is an open door that invites us to remember with respect and to reflect. It is a vivid symbol of the sacrifice that inspires us to take upon ourselves more responsibility towards our children and the generations that will come later, towards the future of the humanity in peace and progress for all.

Ladies and Gentlemen,

It is sad that the horrors of Second World War were not enough to prevent the repetition of genocide in different countries and regions of the world, such as in Cambodia and Rwanda. I come from a region at the heart of Europe where Bosnia and Kosova became the victims of the turn of the ethnic hatred and cleansing. Today, peace and security in the world are faced with a new global threat: the international terrorism. The above mentioned facts should make us more vigilant and more determined in our efforts and fight against the evil. Our view is that alongside the need for development, progress and strengthening of the democracy, our inevitable challenge will be the capability to coexist with one another, to build a world in peace. I am convinced that Yad Vashem with its extraordinary testimonies helps us to deeper realize and better face this

challenge. In this context, Albania rejoices about the encouraging and necessary steps taken lately towards the peaceful solution of the crisis in the Middle East.

Thank you!